



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 185

Tiranë – E hënë, 26 tetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 98/2015 datë 23.9.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 12455
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 6079/3, datë 14.10.2015	Për një shtesë në urdhrin nr. 279, datë 14.6.2012 të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale”, të ndryshuar..... 12455
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 65, datë 20.10.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve nr. 00-2014-1861, datë 11.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2200, datë 24.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 12846, datë 26.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë..... 12456
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 14.10.2015	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike..... 12458
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 14.10.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 12458
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 14.10.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 12459
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 14.10.2015	Mbi licencimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Denas”, me fuqi të instaluar 14.5 MW..... 12460
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 14.10.2015	Mbi licencimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 12460

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 14.10.2015	Mbi rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 6, datë 2.2.2011.....	12461
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 14.10.2015	Mbi rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 2.2.2011.....	12461
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 14.10.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “ C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	12462



LIGJ
Nr. 98/2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 64/2014, “PËR
PUSHTETET DHE AUTORITETET E
DREJTIMIT E TË KOMANDIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen disa ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, e ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura drejtpërdrejt ose nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura.”.

2. Në pikën 3, pas shkronjës “ë”, shtohen shkronjat “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“f) miraton, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje;

g) nxjerr në rezervë ose në lirim, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore.”.

Neni 2

Në nenin 13, pika 2, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Shkronja “rr” riformulohet si më poshtë:

“rr) emëron, liron ose shkarkon nga detyra personelin civil në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil apo që janë në funksione ushtari ose nënoficeri;”.

2. Pas shkronjës “s” shtohet shkronja “sh” me këtë përmbajtje:

“sh) emëron, liron ose shkarkon nga detyra personelin civil në strukturat civile të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.”.

Neni 3

Në nenin 24, pika 2, referenca në shkronjën “d” shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARE
Valentina Leskaj

Miruar në datën 23.9.2015

URDHËR

Nr. 6079, datë 14.10.2015

**PËR NJË SHTESË NË URDHËRIN NR.
279, DATË 14.6.2012 TË MINISTRIT TË
DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE TË SHËRBIMEVE
NOTERIALE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 26, të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në aneksin 1, bashkëlidhur urdhrit nr. 279, datë 14.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

a) Në listën e shërbimeve noteriale, shtohet shërbimi i mëposhtëm:

Emërtimi i shërbimit	Tarifa
Regjistrimi i subjekteve të biznesit	300 lekë

2. Ngarkohen të gjithë noterët për zbatimin e këtij urdhri, si dhe afishimin e tij në një ambient të dukshëm në zyrën noteriale.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të



Çështjeve të Drejtësisë që, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, të bëjë njoftimin e këtij urdhri dhe ndjekjen e zbatimit e tij në vijimësi.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

VENDIM
Nr. 65, datë 20.10.2015

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	Anëtar i	“	“
Fatos Lulo	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.9.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 40 Akti që i përket:

KËRKUES: Dritan Zela etj.

SUBJEKTE TË INTERSUARA: Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave,

Vasil Jovani

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2014-1861, datë 11.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2200, datë 24.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 12846, datë 26.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të Faqe|12456

interesuara, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesit janë trashëgimtarë të Mustafa Zelës, i cili deri në vitin 1939 ka pasur në pronësi një truall me sip. 13027 m², me vendndodhje dhe kufij të përcaktuar. Me vendimin nr. 60, datë 2.9.1939 të Komisionit për Instalimin e Nëpunësve në Tiranën e Re, pronari Mustafa Zela është shpronësuar për pjesën më të madhe të sipërfaqes në pronësi të tij dhe nga sipërfaqja e përgjithshme i ka mbetur në pronësi parcela prej 821m². Duke qenë se paditësit nuk kanë mundur të sigurojnë një dokument hipotekor për origjinën e pronës së mbetur në pronësi, por vetëm dokumente arkivore, ata i janë drejtuar gjykatës me kërkesën për vërtetimin e faktit të pronësisë për sipërfaqen prej 821m², me palë të paditur Bashkinë Tiranë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2462, datë 13.07.2001, ka vendosur: *“Detyrimin e Bashkisë Tiranë të njohë pronar Mustafa Zelën për sipërfaqen e lirë të truallit prej 830m², të ndodhur në bulevardin “Zhanë d’Ark.”. Në arsyetimin e saj, gjykata ka deklaruar se “nga akti i ekspertimit ka rezultuar se kjo sipërfaqe e pretenduar prej palës paditëse është trajtuar si pronë shtetërore nga KKKP-ja, dhe nga kjo e fundit janë dhënë dy vendime kompensimi, përkatësisht nr. 63, datë 25.06.1997, në favor të subjektit Halit Karapici, dhe nr. 378, datë 16.10.2000, në favor të subjektit Vasil Jovani.”.*

3. Me vendimin nr. 45, datë 29.03.2002 të KKKP-së Tiranë, mbi kërkesën e kërkesve për njohje pronësie për sipërfaqen 830m², është vendosur se *“...mëqenëse mbi këtë sipërfaqe nga ana e KKKP-ja Tiranë janë dhënë dy vendime, komisioni do të shprehet pasi të zgjidhet në rrugë gjyqësore mbivendosja.”.*

4. Kërkesit i janë drejtuar AKKP-së për rishikimin e vendimeve të dhëna në favor të subjekteve Halit Karapici dhe Vasil Jovani. Me vendimin nr. 1286, datë 16.11.2011, AKKP-ja ka vendosur mungesën e juridiksionit për të rishikuar këto vendime, mbështetur edhe në vendimin nr. 43/2011 të Gjykatës Kushtetuese që e shfuqizoi dispozitën e ligjit për KKP-në, që i jepte të drejtë drejtorit të AKKP-së të rishikonte vendimet e KKKP-së të dhëna më parë. Në këto kushte, kërkesit iu drejtuan gjykatës.



5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12846, datë 26.12.2012, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe prova.*”.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2200, datë 24.10.2013, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit.*”.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-1861, datë 11.07.2014, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit.*”.

II

8. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e të tria vendimeve, duke parashtruar këto shkaqe:

8.1 Është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës para Gjykatës së Lartë, e cila në kundërshtim me praktikën e zakonshme të saj, që i shqyrton çështjet brenda 4–5 vjetësh nga paraqitja e rekursit, e ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuesve brenda disa muajsh (konkretisht brenda 9 muajve). Gjithashtu, kërkuesit ngrenë dyshime për paanshmërinë e Gjykatës së Apelit, pasi sipas tyre trupit gjykues nuk është caktuar me short, por me urdhër të kryetarit të gjykatës.

8.2 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj dhe arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Kolegjit Civil nuk janë pasqyruar pretendimet sipas rekursit të bërë. Ato madje janë paraqitur në mënyrë të shtrembëruar në hyrje të vendimit dhe nuk u është dhënë përgjigje më tej.

8.3 Është cenuar e drejta për akses në gjykatë, pasi gjykatat e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrimin se paditësit nuk legjitimohen për të ngritur padi në gjykatë, përderisa pronësia e tyre nuk është njohur me vendim të KKKP-së. Gjykatat ngatërrojnë konceptin e legjitimitetit të palëve dhe të juridiksionit apo shqyrtimit të çështjes në themel nëpërmjet administrimit të provave. Nëse paditësit nuk legjitimohen, atëherë gjykatat nuk kishin arsye për t'i hyrë themelit të çështjes.

8.4 Nuk është formuar si duhet ndërgjyqësia, pasi nuk figurojnë dy trashëgimtarë të palës së paditur. Gjithashtu, nuk është njoftuar rregullisht Avokatura e Shtetit, gjë që është detyrim ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Kërkuesit kanë pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit nuk janë respektuar garancitë që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar për rrjedhojë parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën e aksesit në gjykatë.

10. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këto pretendime të kërkuesit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj për asnjërën prej tyre¹. Në kushtet kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

¹ Votuan për pranimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha dhe Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo.



VENDIM

Nr. 117, datë 14.10.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGIJË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA DHE FURNIZUESIT E ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikës “V.1”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008; pikës 4.13 germa “A” pikës 4 dhe pikës 7, germa “g” paragraf. 1, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrisë nr. 338, datë 19.3.2008 dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe draftmarrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe “Furnizuesit” të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Subjektet nënshkruese të kësaj marrëveshje do të jenë:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. e licencuar nga ERE për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 96, datë 27.10.2014;

- Furnizuesi i energjisë elektrike (personi juridik i licencuar nga ERE për kryerjen e aktivitetit të furnizimit me energji elektrike), i cili do të lidhë me vullnetin e tij të lirë marrëveshjen me OSHEE sh.a., për sigurimin e furnizimit me energji elektrike të klientëve fundor.

- Po ashtu, konstatohet se dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori marrëveshjeje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e draftmarrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE sh.a. dhe “Furnizuesit” e energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 118, datë 14.10.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJIA D.O.O VETERNIK” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 germa “d” dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat “a”, “b” dhe “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), (statuti ligjor i shoqërisë), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 119, datë 14.10.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJIA D.O.O VETERNIK” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5 pika 1, germa “P”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar

me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germat “a”, “b” dhe “c”);

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), (statuti ligjor i shoqërisë), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energjia D.O.O Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 120, datë 14.10.2015**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DENAS POWER” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DENAS” ME FUQI TË INSTALUAR 14.5
MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, 39, pika 3 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Denas Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Denas”;

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Denas” me fuqi të instaluar 14.5 MW, për një afat 30 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 121, datë 14.10.2015**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DENAS POWER” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 germa “d” dhe 39 pika 3, dhe nenit 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2 dhe neni 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Denas Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 122, datë 14.10.2015

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “ENERGY
SUPPLY” SHPK, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 6,
DATË 2.2.2011**

Në mbështetje të neneve 16, 43, 110, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4 pika 1 germa “g” dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germa “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “ENERGY SUPPLY” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 6, datë 2.2.2011, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 123, datë 14.10.2015

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “ENERGY
SUPPLY” SHPK, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 5,
DATË 2.2.2011**

Në mbështetje të neneve 16, 43, 110, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4 pika 1 germa “g” dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Energy Supply” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr .5, datë 2.2.2011, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 124, datë 14.10.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “C & S ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “d”, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në

aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germa “c”). Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “C & S Energy” sh.p.k. nuk ka realizuar kontrata të mëparshme.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj ISSH);

- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar (neni 9, pika 4/10, germa “a”); dhe

- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/10 germa “b”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë